



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1299 / prot.  
1

Tiranë, më 01/04/2020

URDHËR

Nr. 222, datë 01.04.2020

PËR

**NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR.132, DATË 08.03.2020 "PËR MBYLLJEN E  
AKTIVITETEVE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE DHE ANULLIMIN E  
GRUMBULLIMEVE MASIVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA"**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma "a", të Ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", Vendimit të datës 08.03.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri, si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

**URDHËROJ:**

1. Në pikën 1 dhe 2 të Urdhrit nr.132, datë 08.03.2020 "Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura", togfjalëshi "deri në datën 3 prill 2020", zëvendësohet me togfjalëshin "deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

